



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 3697/1 Prot
Dt. 07.07.22

447/1
Nr. prot.

Shkodër, më 05.07.2022



Lënda: Mbi Vendimin nr.43, datë 27.06.2022 të Këshillit Bashkiak Vau-Dejes.

KËSHILLI BASHKIAK VAU-DEJES

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 27/1, neni 64, shkronja "c", materialit të dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Nr. 3690 prot datë 4.07.22, shkronja "c", materialit të dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Vau-Dejes "Autorizimin e organit ekzekutiv për të negociuar me bashkitë e qarkut dhe Ministrinë e Infrastrukturës & Energjisë për krijimin e një subjekti të përbashkët në zbatim të VKM Nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura¹ sipas shkreses së Ministrisë Infrastrukturës & Energjisë nr.1950 pror datë 28.01.22".

Prefekti u njoh me autorizimin e organit ekzekutiv për të qenë në rolin e negociuesit, por Këshilli Bashkiak duhet të ketë me patjetër edhe një tjetër vendimarrje sipas kërkesave të nenit 14, pika 5 e ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, përcaktuar kjo edhe në pikën 5 të VKM Nr.302, datë 11.05.2022.

Ju citohet: Marrëveshja e bashkëpunimit ndërvendor miratohet nga këshillat përkatës të secilës prej njësive të vetëqeverisjes vendore që janë palë në marrëveshje. Dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Për secilën palë përcaktohet ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave. Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, subjekti i kompetencave të përbashkëta njofton zyrtarisht Prefektin.

Në njoftimin zyrtar përcaktohen:

- a) emërtimi i njësive të vetëqeverisjes vendore, palë në marrëveshje;
- b) data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes;
- c) qëllimi i marrëveshjes dhe funksioni që do të ushtrohet;
- ç) vendimet e bashkive të përfshira në marrëveshje në lidhje me të;
- d) kontributi i palëve në këtë marrëveshje.

Marrëveshja bëhet e zbatueshme pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



¹ Tregoni kujdes pasi ligji nr.9228/2004 (pjesë e lidhjes nr.2 e VKM) është shfuqizuar me ligj nr.25/2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KESHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 43, datë 27.06.2022

“PËR

**“PJESËMARRJEN E BASHKISË VAU DEJËS NE SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË
PËRBASHKËTA ME QELLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME
UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE
TË NDOTURA”**

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të nenit 14, nenit 23, (pika 1 dhe 2), nenit 54 gërma gj) neni 55 pika 3 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, të VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Per politikat kombetare per riorganizimin e sektorit te furnizimit me uje dhe te largimit, trajtimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura”, Shkresës nr. 950 prot datë 28.01.2022 dërguar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë, në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, për të negociuar me bashkitë e Qarkut dhe/ose bashkitë nga qark tjetër në afersi gjeografike si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për mundësinë lidhjen e marrëveshjes specifike për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit .(kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura).
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës”qe pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia do të jete aksionare, të vijoje me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionareve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës”, për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktore dhe noterial me qëllim transferimit të veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK qe do të krijohet.

3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritetit, Shoqëria e Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës, përndjekjen dhe zbatimin e vendimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR

Mark BISHA

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ardian CELEPIJA

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 04.07.2022